

## **AKT -THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE “BIOPRODUCTS” SH.P.K**

### **Neni 1 Baza Ligjore**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë , në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “ Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqeritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij të lirë sot me dt, 19.06.2018, ortaku i vetëm z. Bledar Daci, i biri i Luan dhe Shpresa, i datëlindjes 02.09.1987, me Nr ID: 032147400 dhe Nr. Personal: I70902104V, lindur në Gështenjas, Kukës, dhe banues ne Kamez, Tirane, me adresë Rr. Abdi Bej Toptani, Godina Nr. 21, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, merr përsipër të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, e quajtur “BIOPRODUCTS” sh.p.k.

### **Neni 2 Themelimi**

Themelohet shoqëria tregtare private e quajtur “BIOPRODUCTS” sh.p.k . Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do te ketë selinë dega.

### **Neni 3 Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë tregtare private “BIOPRODUCTS” sh.p.k. do të ketë selinë në Kamez,Tiranë, në Rrugë Rr. Abdi Bej Toptani, Godina Nr. 21. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të Asamblesë së Oktakëve (ortakut të vetëm).

### **Neni 4 Objektivi i Veprimitarës**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushat si: Mbareshim te kafsheve dhe shpendeve te te gjitha llojeve. Thertore. Shitje dhe blerje lekurash. Tregeti e kafsheve te gjalla. Import. Eksport. Veprimitari ne fushen e prodhimit, magazinimit, e tregimit te prodhimeve blegtorale dhe bujqesore. Tregeti, import, eksport duke perfshire magazinimin dhe tregimin e paisjeve per thertoret, mallrave ushqimore, blegtorale dhe bujqesore, si dhe te cdo sendi tjeter qe eshte ne qarkullimin civil. Kurse te formimit profesional. Transport mallrash nga brenda dhe jashtë shqiperise, per vete dhe per te tjere. Veprimitari ne fushen e ndertimit dhe rikonstrukzionit te objekteve. Cdo veprim tjeter qe perfshihet ne fushen perkatese.

### **Neni 5 Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Shoqëria ka kohëzgjatje pa afat. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkaku.

**Neni 6**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali fillestari i shoqërisë private “BIOPRODUCTS” sh.p.k. do të jetë 100 (Njëqind) lekë . Kapitali është 100% nga kuota e ortakut të vetëm, e ndarë në (Një) 1 kuotë. Kapitali themeltar fillestari mund të shtohet ose të pakësohet ( por jo nën vleren e kapitalit themeltar fillestari).

**Neni 7**  
**Drejtimi i Shoqërisë**

Administratori I Shoqerise emerohet Bledar Daci i biri i Luan dhe Shpresa, i datëlindjes 02.09.1987, me Nr ID: 032147400 dhe Nr. Personal: I70902104V, lindur në Gështenjas, Kukës, dhe banues ne Kamez, Tirane, me adresë Rr. Abdi Bej Toptani, Godina Nr. 21, te cilit i atribuohen te gjithë kompetencat , perveç atyre të cilat ligji ia njeh shprehimisht Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i vetëm).

Administratori qëndron në detyrë nga data e themelimit të kësaj shoqërie për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Ai është përfaqësuesi i shoqerisë në marredhënie me të tretët dhe ka kompetenca te plota në drejtimin e saj .

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga një perfaqësues i pajisur me prokurë të përgjithshme ose të posaçme .

**Neni 8**  
**Të ardhurat**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm.

**Neni 9**

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financierë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pranojë persona të tjerë si ortakë .

**Neni 10**  
**Zgjidhja e konflikteve**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

**Neni 11**  
**Vula**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj .



### **Neni 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

### **Neni 13**

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do te mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "BIOPRODUCTS" sh.p.k.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm.

**ORTAKU I VETËM**  
**Bledar Daci**

*Bledar Daci*  
*B.D.*